



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 538/2 Prot.

Durrës, më 20.3.2024

VENDIM

Nr. 14, datë 20.3 2024
PËR

**"MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR SIGURIMIN E STANDARTEVE TË
CILËSISË PËR PERIUdhËN 2023-2025 NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR
MOISIU" Durrës"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 46, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të UAMD-së, të Rregullores së UAMD-së, të Relacionit nr. 478 prot, date 04.03.2024 "Propozim mbi Planin e veprimit për Sigurimin e Standarteve të cilësisë për periudhën 2023-2025 në UAMD" të NJSBC-së në nivel Institucional, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Veprimit për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë për periudhën 2023-2025 në Universitetin "Aleksandër Moisiu", sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë
 - Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
 - Drejtoria e Administrimit dhe e Shërbimeve Akademike

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Nr. 478 prot

Durrës, më 06.03. 2024

Lënda : **Propozim mbi Planin e Veprimit për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë për periudhën 2023 - 2025**

Drejtuar: **Prof.Dr. Kseanela Sotirofski, Rektor**

E nderuar znj. Rektore,

Nisur nga procesi në vijim i akreditimit të programeve të studimit në UAMD, diskutimet dhe propozimet e ekspertëve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit mbi përmirësimin e elementëve që kanë të bëjnë me cilësinë, standardet dhe kriteret për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, si dhe Rregullores për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, Njesia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka propozuar një Plan Veprimi me masa dhe aktivitete konkrete, struktura zbatuese dhe afatet përkatëse për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në UAMD.

Zbatimi i masave të përfshira në këtë draft dokument nga të gjitha strukturat, do t'i shërbente përmbushjes së plotë të standardeve të cilësisë të përfshira në Raportet e Vlerësimit të Brendshëm për akreditimin e programeve të studimit dhe dokumentimit të tyre me evidenca konkrete dhe relevante.

Sa më sipër, lutemi në miratimin e këtij plani nga ana Juaj dhe dërgimin e tij tek të gjitha strukturat përgjegjëse për zbatim.

Duke ju falënderuar,

KRYETAR

Prof. As. Dr. Elton NOTI

MIRATOHET
REKTORI

PROF.DR KSEANELA SOTIROFSKI

PLAN VEPRIMI MBI SIGURIMIN E STANDARDEVE TË CILËSISË PËR PERIUDHEN 2023 – 2025

Nr	Aktiviteti	Struktura zbatuese	Periudha e realizimit	Shënime
1	Vlerësimi semestral i cilësisë së mësimdhënies së pedagogëve nga studentët	Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC)	Java e trembëdhjetë e semestrit	Plotësimi i pyetësorëve nga ana e studentëve për vlerësimin e çdo pedagogu, sipas formatit dhe metodologjisë së miratuar.
2	Përgatitja e Raporteve Vjetore të Vetëvlerësimit: 1. Në nivel institucional 2. Në nivel fakulteti	1. DKSC, NJSBC në nivel institucional; 2. NJSBC në nivel fakulteti.	Brenda muajit Mars të vitit pasardhës për vitin paraardhës.	Sipas formatit të paraqitur ne Aneksin 1.
3	Përgatitja e "Udhëzuesit mbi Metodatat Inovative të Mësimdhënies"	NJSBC në nivel institucional	Brenda Muajit Mars	Hartimi i një dokumenti ku përshihen metodat bashkohore të mësimdhënies si një instrument i rëndësishëm cilësie në arsimin e lartë.
4	Përgatitja e një kalendarit trajnimesh për stafin akademik të UAMD-së, me qëllim rritjen e performancës akademike të stafit me kohë të plotë dhe të pjesshme.	Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënive me jashtë në UAMD, Dekanët e fakulteteve, Qendra për Edukimin në Vazhdim (QEV).	Përgatitja e kalendarit (Deri në datën 30 Mars) Realizimi i trajnimeve (Mars - Qershor)	Dekanët e fakulteteve dhe QEV përgatisin një listë me tema mbi të cilat do të zhvillohen trajnimet, si dhe trajnerët e propozuar.
5	Përfshirja e studentëve dhe propozimeve të mundshme të tyre në vendimarrjet e njëjësive baze.	Njësitë bazë të fakulteteve	Përgjatë të gjithë vitit akademik	Ftesë drejtuar përfaqësuesve të studentëve për të marrë pjesë në disa mbledhje departamenti, me qëllim dëgjimin e problematikave të studentëve dhe propozimeve që ata kanë në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Pjesëmarrja e tyre të dokumentohet.

MIRATOHET
REKTORI
PROF.DR KSEANELA SOTIROFSKI

6	Rifreskimi i programeve lëndore (syllabuseve) çdo fillim semestri në drejtim të literaturës së përdorur dhe tematikave përkatëse	Dekanët e fakulteteve Njësitë bazë	Jo më vonë se dy javë përpara fillimit të semestrit përkatës	Cdo përgjegjës departamenti i kërkon anëtarëve të tij me kohë të plotë dhe të pjesshme, dy javë përpara fillimit të semestrit, të rifreskojnë syllabuset e lëndëve që lektrojnë. Mund të iniciohet një vendim dekanati për të formalizuar këtë proces.
7	Zhvillimi i leksioneve të hapura nga stafi akademik	Anëtarët e stafit akademik	Cdo semestër të vitit akademik	Leksionet e hapura duhet të praktikohen edhe si një instrument i monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave inovative të zbatuara nga lektorët.
8	Marria e propozimeve nga bashkëpunëtorët dhe ekspertët e jashtëm mbi përmirësimin e programit të studimit dhe adresimin e nevojave të tregut të punës.	Njësitë bazë	Brenda muajit Maj	Departamentet mund të organizojnë takime periodike, në formën e ëorkshopeve apo takimeve në departament ku aktorët e tregut të punës ftohen të japin sugjerime mbi përmirësimin e programit të studimit. Mund të bëhet edhe nëpërmjet e-maileve apo letrave të dërguara në drejtim të departamentit. Procesi duhet të dokumentohet.
9	Përgatitja e raportit vjetor të departamentit mbi veprimtaritë mësimore, kërkimore – shkencore, aktivitetet, projekteve etj	Njësitë bazë	Brenda muajit Shkurt të vitit pasardhës për vitin paraardhës.	
10	Gjurmimi i punësimit të studentëve të diplomuar (Alumni)	Sektor i Karrierës dhe Alumni Njësitë bazë	Përgjatë vitit akademik	Identifikimi i institucioneve ku janë të punësuar ish studentët (Alumni), realizimi i intervistave

MIRATOHET
REKTORI
PROF.DR KSEANELA SOTIROFSKI

			dhe kontakte me ish- studentët, punëdhënësit apo ekspertët e fushës përkatëse ku bën pjesë programi i studimit. Sektor i Alumni-t i përcjell të dhënat e mbledhura gdo departamenti, sipas programit të studimit përkatës.
11	Realizimi i seancave informuese per stafin akademik mbi proceset e akreditimit të programeve të studimit, kryesisht me anëtarët e GVB-ve, koordinatorët e programeve të studimit etj,	DKSC, NJSBC ne nivel institucional, NJSBC ne nivel fakulteti,	Në varësi të periudhave dhe afateve të akreditimit.
12	Plotësimi vijtor i Formularit të Vetvlerësimit të Performancës së Personelit akademik	Njësitë bazë	Brenda muajit Qershor
			Përfaqësues të strukturave të përfshira në këtë aktivitet, informojnë stafin përkatës mbi standardet e cilësise për akreditimin e programit, kuadrin ligjor dhe ndryshime eventuale, dokumentacionet shoqëruese, raportet e vlerësimit të brendshëm etj. Plotësimi i formularit sipas formatit të miratuar

MIRATOHET
REKTORI

PROF.DR KSEANELA SOTIROFSKI

Aneksi 1. Formati I Raportit të Vetvlerësimit të Fakultetit

PËRMBAJTA

VETËVLERËSIMI PËRGJAT VITIT AKADEMIK 2022-2023 (PROCEDURA DHE AKTIVITETE)
REALIZIMI (OBJEKTIVAT E VITIT TË MËPARSHËM NESE JANË REALIZUAR DHE PRODUKTI)
QËLLIMI (QËLLIMI I RAPORTIT)
VETËVLERËSIMI NË FAKULTET
HISTORIKU I FAKULTETIT
ORGANIZIMI I FAKULTETIT
BAZA LIGJORE DHE AUTONOMIA NË ORGANIZIMIN E BRENDSHËM
BASHKËPUNIMI ME KOMUNITETIN E QYTETIT
NDËRKOMBËTARIZIMI DHE PARTNERITETET
PROJEKTET
RESURSET E FAKULTETIT
KURRIKULAT
MËSIMDHËNIA DHE KËRKIMI SHKENCORË
STUDENTËT
SHËRBIMET NDAJ STUDENTËVE – SEKRETARIA MËSIMORE
PIKA TË FORTA TË FAKULTETIT